

MIMOZA PRIKU

PATOSI KOMUNIKATIV NË TEKSTIN POETIK TË ETËHEM HAXHIADEMIT¹

Qëllimi ynë në këtë punim është ta vështrojmë tekstin poetik të Etëhem Haxhiademit në një dimension të ri, në atë të pragmatikës komunikative, e cila tradicionalisht është vënë në zbatim më tepër në prozë. Teknikat që përdor poeti në thurjen e diskursit poetik nuk janë thjesht teknika letrare, por mekanizma gjuhësorë që bashkëveprojnë për të arritur një rezultat estetik, siç është poezia, e cila në këtë kontekst do të konsiderohet jo si një kompetencë, por si një performancë, si një akt gjuhësor, po edhe poetik. Megjithëse Haxhiademi është më shumë i njohur për tekstin dramatik se për atë poetik, do të përqipemi të zbulojmë disa nga treguesit pragmatikë të pranishëm në përmbledhjen poetike “Lyra”, të botuar në vitin 1939. Vëmendja do të përqendrohet në zbulimin e efekteve pragmatike të zgjedhjeve gjuhësore që bën poeti, duke u ndalur në veçanti në aktin kumtues, në rolin e deiktikëve dhe në disa elemente të tjera me peshë të veçantë në pragmatikën komunikative. Jemi të vetëdijshëm që ky punim vetëm sa do të hapë disa dritare të reja për ta lexuar dhe studiuar poezinë e Haxhiademit.

Teksti poetik si dëshmi e pragmatikës komunikative

Pragmatika është një fushë kërkimore në të cilën ndërthuren shumë elemente, mes të cilave janë edhe ato me natyrë gjuhësore. Për këtë arsye thuhet se “pragmatika ka nevojë për gjuhësinë -

¹ I jemi referuar në shembuj botimit të cituar si më poshtë: Etëhem Haxhiademi, *Lyra*, Tiranë, Shtypshkronja “Dielli”, 1939.

dhe gjuhësia ka nevojë për pragmatikën”². Po duke qenë se gjuha është pjesë e kulturës, natyrshëm edhe ndërtimi i akteve gjuhësore nuk mund të shihet vetëm si çështje e rregullave pragmatike, por ato duhen vështruar edhe si produkt i vetë gjuhës dhe i ndikimit kulturor, ndaj dhe interpretimi i kontekstit sociokulturor është i pashmangshëm. Në këto rrethana mund të nënvizojmë faktin se interpretimi i vetë kontekstit nuk është i thjeshtë sepse për nga natyra e tij konteksti përmban nënkontekste dhe ligjërimi përmban nëndiskurse, dhe nënkontekstet mishërojnë kontekstin dhe nëndiskurset mishërojnë diskursin. Për të kapur natyrën dinamike të kontekstit dhe të diskursit nevojitet një qasje e integruar me gjuhësinë, psikologjinë, sociologjinë dhe studimet kulturore³.”

Ky fakt na çel rrugën për ta interpretuar një tekst, qoftë ai edhe poetik, si një produkt letrar, gjuhësor, pragmatik, social e kulturor. Edhe misioni dhe objekti i pragmatikës nuk është vështruar e as interpretuar gjithëherë në të njëjtën mënyrë. Disa prej studiuesve e kanë personifikuar pragmatikën vetëm me parimet e përdorimit të gjuhës, duke e kufizuar mjaft fushën e veprimit pragmatik dhe duke e privuar atë nga lidhjet dhe përshkrimet e strukturës gjuhësore. Nëse i referohemi dallimit të Chomsky-t midis kompetencës dhe performancës, “pragmatika ka të bëjë vetëm me parimet e performancës të përdorimit të gjuhës”⁴.

² Anita Fetzer, “Pragmatics as a linguistic concept”, në *Foundations of Pragmatics. Handbooks of Pragmatics*, Vol. 1, edited by Wolfram Bublitz and Neal R. Norrick, De Gruyter Mouton, 2011, f. 38.

³ Anita Fetzer, “Conceptualising discourse”. Në *Pragmatics of Discourse. Handbooks of Pragmatics*. Vol. 3, edited by Klaus P. Schneider and Anne Barron, De Gruyter Mouton, 2014, f. 56.

⁴ Stephen C. Levinson, *Pragmatics*, Cambridge University Press, 2008, f. 7.

Ndërkohë studimet me karakter pragmatik⁵ kanë sjellë në vëmendje mes të tjerash statusin e dyfishtë të ligjërimit, si proces e si produkt, pa lënë jashtë vëmendjes diskursin, aktin komunikativ. Edhe sipas studiuesve shqiptarë: “Pas një gjuhësie të përqendruar te gjuha (si sistem), këta dhjetëvjeçarët e fundit po orientohen studimet në lëmin e ligjërimit, të aktit kumtues, të akteve konkrete të të vepruarit me anë të gjuhës”.⁶

Në këtë punim do të ndalemi pikërisht tek akti komunikativ, i veshur me një mesazh i cili kërkon të tërheqë vëmendjen e audiencës, prodhon efekte kontekstuale dhe ndërveprime pragmatike mes atij që flet dhe atij që dëgjon. E gjithë kjo “lojë” gjuhësore na drejton nga disa tregues që kanë natyrë pragmatike, të cilët do të përpiqemi t’i zbulojmë në poezinë fine të Etëhem Haxhiademit. Përmbledhja “Lyra” përfshin poezi të shkruara në harkun kohor 1927-1937 dhe të botuara në vitin 1939. “*Një punë e pakët, por e kujdesëshme*, - do të shprehej vetë poeti, - *qi besoj se do t’i vlejë mjaft literaturës s’onë të vorfën*”⁷.

Krijimtaria poetike e Haxhiademit është pritur mirë dhe u vlerësua nga bashkëkohësit e poetit tonë. Publicisti Vangjel Koça shprehet kështu në një prej shkrimeve të tij: “Dhe kur herë pas here largohet gjiri i Melpomenës dhe mer lyrën për të kënduar, Haxhiademi s’e haron humanistin dhe kështu ëndërat e tija poetike i vesh dëndur me symbòlet e mythologjisë greke. Këtë na provon LYRA e tij, në të cilën Haxhiademi përmbledh vjershat që ka botuar kohë pas kohe në Austri dhe në Shqipëri. Nga këtë vjersha duhet të veçojmë “Nymfat e Shkuminit”, që e nderojnë poezinë shqiptare. Nuk bien poshtë edhe “Nata e Zezë”, “Naim Frashërit”, “Lufta e Drangojvet me Kuçedrën”. Janë xhevaire që

⁵ Shih: Xh. Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Shtëpia botuese Albas, Tiranë, 2015.

⁶ Sh. Rrokaj, *Filozofi e gjuhës. Prej Antikitetit deri në kohën e sotme*, Arbëria, Tiranë, 2010, f. 203.

⁷ “Parathanëje”, *Lyra*, Tiranë, 1939, f. 5.

mallëngjejnë⁸.”

Në fushën e letrave Etëhem Haxhiademi qe vlerësuar si para viteve ‘30-40, ashtu edhe pas viteve ’90, ndërsa sa i përket kodit gjuhësor të tij i është kushtuar më pak vëmendje. Përmendim Tomorr Plangaricën, që cilëson pikërisht: “Jo vetëm dramaturgu, por edhe poeti (mbi krijimtarinë poetike të Etëhem Haxhiademit)”⁹.

1. Akti kumtues

Kur diskutohet rreth dimensionit pragmatik, pika e parë e referimit është pikërisht akti i komunikimit. Ai është studiuar në këndvështrime të ndryshme. Në pikëpamje pragmatike një vëmendje të veçantë i ka kushtuar John Langshaw Austin (1911-1960)¹⁰ nga i cili kemi trashëguar edhe klasifikimin në akte: *lokutore*, *ilokutore* dhe *perlokutore*. Sot në pragmatikë diskutohet për teorinë e akteve të komunikimit duke e zgjeruar dhe shtjelluar më tej në disa drejtime konceptin e Austin-it¹¹. Punën e këtij gjuhëtari e vazhdoi filozofi amerikan John Searle fillimisht me veprën “*Speech Acts: An Essay in the Philosophy of Language*” (1969) dhe me disa punime të tjera në vazhdimësi. Sipas Austin-it

⁸ Vangjo Nirvana (Vangjel Koça), “Abeli” dhe “Lyra: të Etëhem Haxhiademit”, *Tomori*, Tiranë, 1940.

⁹ Tomorr Plangarica, “Jo vetëm dramaturgu, por edhe poeti (mbi krijimtarinë poetike të Etëhem Haxhiademit)”, në *Univers i vlerave të munguara* (ribotim), Sejko, Elbasan 2002, fq. 100-111.

¹⁰ J. L. Austin, *How to do Things with Words*, 1962; *Speech acts - An Essay in the Philosophy of Language*, 1969. (vepra postume).

¹¹ John R. Searle, *Speech Acts: An Essay in the Philosophy of Language*, Cambridge, Cambridge University Press, 1969; Robert M., Harnish, *Mood, meaning and speech acts*. In: Savas Tsohatzidis (ed.), *Foundations of Speech Act Theory: Philosophical and Linguistic Perspectives*, 407–459. London: Routledge, 1994; William P. Alston, *Illocutionary Acts and Sentence Meaning*. Ithaca: Cornell University Press, 2000 etj.

një akt lokutor realizohet nëpërmjet shqiptimit të një fjalie me kuptim dhe referencë (1962:92), ndërsa akti ilokutor “është veprimi i performuar me anë të forcës lidhur me një shprehje të caktuar gjuhësore. Ai është performanca e një akti në thënien e diçkaje, si dallim i performancës së një akti të thënies së diçkaje” (1962:99). Akti i komunikimit me pak fjalë në këtë rast shihet si performim i një aktiviteti të të folurit. Së fundi, akti perlokutor është akti performativ i cili synon arritjen e një efekti të caktuar.

Në krijimtarinë e Haxhiademit do të ndalemi në analizën e disa akteve ilokutore dhe perlokutore. Prania e këtyre akteve dhe forca komunikative që ato transmetojnë, është më e dukshme në poezinë “Naim Frashërit”. Nga ky krijim mund të veçojmë vargjet: *Kujtoni pra se nashti koha erdhi/Të qasni priftin pran’ qi ju bekoi* (Lyra, *botim i cituar*, f. 36, vargu 109); *Ejani prá të shkojmë/ E t’mos vonojm’ mâ gjatë* (Lyra, *botim i cituar*, f. 36, vargu 122); *Të shkulim edhë çka prej trupit tij ka mbetun* (Lyra, *botim i cituar*, f. 36, vargu 125). Nga këta shembuj të bie në sy fakti se nxitja për të vepruar shprehet qartë përmes formave foljore të cilat janë kryesisht në mënyrën lidhore (*të qasni, t’mos vonojm’, të shkulim* etj.), mënyrë e cila vishet me modalitet urdhëror, por nuk mungojnë gjithashtu edhe foljet në mënyrën urdhërore (*ejani*). Po nga vëllimi “Lyra” veçojmë poezinë “Asaj”, në të cilën prania e këtyre akteve shfaqet sidomos në tri vargjet e kësaj poezie:

Përsri me u gëzumun/Prandaj fëtyrën ktheje/ Dhe fol përpara meje (Lyra, *botim i cituar*, f. 45, vargjet 28, 29, 30).

Foljet në urdhërore *ktheje, fol* e dëshmojnë më së miri entitetin dhe forcën e këtyre akteve.

Në teorinë e akteve të komunikimit një vend me rëndësi zë edhe forca ilokutore. Në rastet e ndërtimeve kur një folje gjysmëndihmëse ndiqet menjëherë nga një pjesore apo një folje në formë të pashtjelluar apo të shtjelluar, forcën e mesazhit e mbart folja bazë, ndërsa kur mes tyre ndërhyjnë fjalë të tjera, është zakonisht folja gjysmëndihmëse e cila mbart forcën e

mesazhit, ndërsa folja kryesore mban vetëm peshën leksikore. Le të krahasojmë vargjet e mëposhtme:

a. *Kúr zan' rrotullohen* (“Nymfat”, *Lyra, botim i cituar*, f. 12, vargu 71);

b. *...nisi me kang' t' kallxojë veprat e parëve* (“Nymfa”, *Lyra, botim i cituar*, f. 15, vargu, 122);

Ndërsa kur mes foljes gjysmëndihmëse dhe foljes bazë hyn një deiktik, atëherë ai tërheq me vete edhe forcën ilokutore, p.sh.: Dhe *nisi ambël pastaj me pergdhelun* (“Nymfa”, *Lyra, botim i cituar*, f. 16, vargu 167); E *tyke lojtun ambëlsisht dëfrehen* (“Nymfat e Shkumbinit”, *Lyra, botim i cituar*, f. 10, vargu 15); Sá kish *fillumun mir' qi të errsohesh* (“Nata e zezë”, *Lyra, botim i cituar*, vargu 11).

2. Deiktikët

Në teorinë pragmatike deiktikët janë elemente me rëndësi. Ata shpesh e drejtojnë vëmendjen nga vetë akti komunikativ, duke u përpjekur në zbulimin e referencave të ndryshme pragmatike, por gjithmonë në lidhje të ngushtë me kontekstin. Në aktin komunikativ janë të përfshirë persona (njerëz), vende, kohë dhe roli i këtyre deiktikëve është pikërisht zbulimi i referentit në këto akte. Në poezinë e Haxhiademit përemrat zënë një vend të rëndësishëm me rolin e tyre si deiktikë. Do të shohim përemrat vetorë në rolin e deiktikëve, ndajfoljet kryesisht ato të vendit dhe të kohës. Deiktikët kohorë mund të realizohen si nëpërmjet sistemit të kohëve, por edhe modifikuesve kohorë, si ndajfoljet kohore.

2.1. Përemrat

Përemri i vetës së parë “unë” nga pikëpamja pragmatike tërheq vëmendjen rreth individit që mban rolin vendimtar në komunikim, duke marrë me vete edhe forcën pragmatike p. sh. *Muë nga një her’ për ty me shpresën rroja* (“Gallatës”, vargu 20, f. 8); *Un duë të shoh me sy* (“Prej së largut”, *Lyra, botim i cituar*, f. 41, vargu 24); *Dhe un me gas i qasem vargut t’ uëj* (“Kanga shekullore”, *po aty, botim i cituar*, f. 64, vargu 13); *Por un për ty do t’shkrihem* (“Asaj”, *Lyra, botim i cituar*, f. 44, vargu 7) etj.

Në pjesën dërrmuese të rasteve situata komunikative është më e ndërlikuar, pasi mund të ndërthuren dy role pragmatike njëherazi: roli i dhënësit të mesazhit dhe ai i llojit të veprimit që kryen dhënësi p.sh.

a. Si *endem un këtu* (“Prej së largut”, *po aty, botim i cituar*, f. 42, vargu, 62), *Se muë më prishet gjaku* (“Prej së largut”, *po aty, botim i cituar*, f. 42, vargu 52);

b. *Un shtanga bashk’ me motrat dhe me vllan* (“Nata e zezë”, *po aty, botim i cituar*, f. 24, vargu 21); *Dhe un të ndoqa pas* (“Prej së largut”, *po aty*, f. 42, vargu 62);

c. *E kush munt t’më përmbante muë ather?* (“Nata e zezë”, *po aty, botim i cituar*, f. 29, vargu 151);

Në shembujt që i përkasin kategorisë së parë (a), deiktiku, që është në këtë rast përemri vetor i vetës së parë, del i shoqëruar me veprimin i cili shprehet me një folje në kohën e tashme. Në disa vargje përemri “unë” bashkëshoqërohet me një tjetër deiktik, me trajtën e shkurtër, e cila përforcon në këtë rast rolin e dhënësit të mesazhit. Në rastet e kategorisë (b) paraqitet e markuar edhe koha si distancë, e materializuar kjo me kohën e kryer të thjeshtë të foljes.

Në shembujt e grupit të tretë (c) skema paraqitet e tillë: *deiktik+trajtë e shkurtër+ndajfolje kohe*. Siç shihet, roli i deiktikut fuqizohet me trajtën e shkurtër nga njëra anë dhe prania e një deiktiku kohor, nga ana tjetër.

Përveç përemrit të vetës së parë “unë”, si deiktikë të markuar në poezinë e Haxhiademit, dalin në shumë raste edhe vetorët e vetës së dytë, p.sh.:

Ti qe, o shpirt i vlershëm, nga të parët (“Kanga shekullore”, *po aty, botim i cituar*, f. 65, vargu 34); *E lumin ti kûr don me pa* (“Prej së largu”, *po aty, botim i cituar*, f. 41, vargu 41).

Në përdorime kataforike dalin kryesisht përemrat dëftorë, si p.sh.: *Oh, sa e errët ajo dit’ gëdhini!* (“Nata e zezë”, *po aty, botim i cituar*, f. 30, vargu 171).

Por ka edhe raste të rralla kur rolin kataforik mund ta luajë edhe ndonjë përemër vetor, si: Kur *ti*, *Sofi*, kërruse (“Prej së largu”, *po aty, botim i cituar*, f. 41, vargu 45).

2.2. Deiktikët e vendit

Deiktikët e vendit zakonisht vënë përballë dallimet në vendndodhje mes “këtu” dhe “atje” apo “afër” e “larg” në lidhje me atë që shpesh njihet si *qendra deiktike*¹². Këto pozicione sigurisht sqarohen nga konteksti. Edhe në diskursin lirik, megjithëse më rrallë, përballemi me deiktikët e vendit, si *larg*, *afër*, *rrotull* etj. Këtë përdorim mund ta ilustrojmë me shembujt e mëposhtëm:

Ato jan’ ndemun n’ujin e kullumun/ E trupat lark u duken bor’ të bardha/ (“Nymfat e Shkumbinit”, *po aty, botim i cituar*, f. 10, vargu 6); *Rrotull zun’ t’ vishin* (“Nymfa”, *po aty, botim i cituar*, f. 19, vargu 220).

¹² Stephen C. Levinson, *Pragmatics*, Cambridge University Press, 2008.

Në mbështetje të deiktikëve të vendit vijnë në këtë rast emrat e përemrat (*ato*, *Nymfat*, *trupat*), mbiemrat (*e kulluemun*, *bor' të bardha*) që së bashku me skemat gramatikore e kontekstualizojnë largësinë e shprehur nga ndajfolja.

Deiktikët, sidomos *ato* të vendit, në poezinë e Haxhiademit gjenden në role kataforike, si p.sh.:

Atje mbi mal kuçedra del e shtrihet (“Lufta e dragojve me kuçedrën”, *po aty, botim i cituar*, f. 48, vargu 33); *Atje mbi ajër tyke fluturumun* (“Lufta e dragojve me kuçedrën”, *po aty, botim i cituar*, f. 50, vargu 83) etj.

Por nganjëherë deiktikët e vendit mund të vendosen edhe në role anaforike p.sh. *E lark atje, ku buçet/ Danubi me tallaze/* (“Prej së largu”, *po aty, botim i cituar*, f. 40, vargu 17).

Dimensioni pragmatik i vendit është mjaft dinamik dhe ky dinamizëm përveçse me kundërvënien e foljeve, mundet mjaft mirë ta gjejë shprehjen e vet me deiktikët e vendit.

Deiktikët kohorë

Ndajfoljet e kohës në rolin e deiktikëve janë më të dendura dhe mund të hasen në secilën prej poezive të përfshira në vëllimin “Lyra” të poetit elbasanas. Për ilustrim mund t’u referohemi vargjeve: *Athere ti as kryët s’e ktheje mrapa* (“Gallates”, *po aty, botim i cituar*, f. 7, vargu 11.); *Ahere kur që gjallë* (“Nata e zezë”, *po aty, botim i cituar*, f. 27); *Kur për gjithmon’ ja mbylle syt ksaj bote* (“Naim Frashërit”, *po aty, botim i cituar*, f. 33); *Dhe sot, Sofi, ti kúr kalòn* (“Prej së largu”, *po aty, botim i cituar*, f. 40) etj.

Në poezinë e Haxhiademit shpesh ndeshemi me vargje në të cilat treguesit kohorë ndërthuren me njëri- tjetrin. Në shembullin:

Atehere ke me lshumun/ Dhe ti ca pika loti (“Asaj”, *po aty, botim i cituar*, f. 44, vargu 13), ndajfolja kohore *atëherë* në rolin e deiktikut, është mpleksur me mjaft art me ndërtimin foljor *ke me lshumun* që ka kuptimin e kohës së ardhme të mënyrës dëftore (= *do të lëshosh*).

Kur flasim për deiktikët e kohës, koha e kodimit dhe ajo e dekodimit përgjithësisht ndihmohet jo vetëm nga prania e këtyre deiktikëve, por edhe nga koha e foljes që del në atë kontekst.

Emrat e përveçëm

Emrat e përveçëm kanë qenë padyshim një nga temat më të diskutuara në filozofi, në filozofinë e gjuhës e së fundmi edhe në pragmatikë. Idenë që emrat janë krijuar për të ndihmuar në zbulimin e natyrës së vërtetë të gjërave, e gjejmë që tek dialogët e Platonit e sidomos tek Kratili. Ndërsa G. Frege ([1892] 1980) e përcakton rolin e emrave të përveçëm në këtë mënyrë: “Referenca e një emri të përveçëm është vetë objekti të cilin ne e përcaktojmë përmes mjeteve të tij.” ([1892] 1980: 60).

Referenca e një emri të përveçëm është edhe një problem pragmatik, sepse qartësimi i semantikës së tij ndihmohet edhe nga mjaft faktorë që janë me natyrë pragmatike. Pra, kur akti komunikativ shoqërohet me një emër të përveçëm, kompleksiteti kuptimor vjen e bëhet dalëngadalë më i qartë. Në poezinë e Haxhiademit emrin e përveçëm si referent e gjejmë që në disa tituj të poezive të tij, por edhe në brendësi të këtyre krijimeve poetike. Kujtojmë disa prej titujve të poezive, si: “Galatés”, “Nymfat e Shkuminit”, “Naim Frashërit” të cilat na udhëheqin menjëherë drejt referentit.

Në rastet e tjera brenda poezive gjejmë se përdorimi i emrave të përveçëm është më i dendur. Le ta konkretizojmë me vargjet: *E nga një her’ me synin plak vështronte/ Najadat me Satirët të trazumun* (“Nymfat e Shkuminit”, *po aty, botim i cituar*, f. 14); *E pse mbas jush Antropja mos të shkoj’* (“Nata e zezë”, *po aty, botim i cituar*, f. 28); *Nëpër mbretni t’Neptunit do t’kalojmë* (“Naim Frashërit”, *po aty, botim i cituar*, f. 36); *Më thuëj, Sofi, me cilin flet* (“Prej së largu”, *po aty, botim i cituar*, f. 40) etj.

Në përmbledhje të argumenteve që parashtroam më lart mund të themi se mjetet që përdor poeti Etëhem Haxhiademi për

të realizuar forcën komunikative janë të larmishme dhe meritojnë një vëmendje të veçantë dhe analiza më të hollësishme. Studimet e thelluara në këtë këndvështrim do të mund të na japin një dimension të ri të krijimtarisë poetike të Haxhiademit.

BIBLIOGRAFI

- Alston, W.P., *Illocutionary Acts and Sentence Meaning*, Cornell University Press, Ithaca, 2000.
- Austin, John, *How to do things with words*, edited by J.O.Urmson, Harvard University Press, 1962.
- Fetzer, Anita, “*Pragmatics as a linguistic concept*”, në *Foundations of Pragmatics. Handbooks of Pragmatics*, Vol. 1, edited by Wolfram Bublitz and Neal R. Norrick, De Gruyter Mouton, 2011, f. 23-50.
- Fetzer, Anita, “*Conceptualising discourse*”, në *Pragmatics of Discourse. Handbooks of Pragmatics. V.. 3*, edited by Klaus P. Schneider and Anne Barron. De Gruyter Mouton, 2014, f. 35-64.
- Levinson, Stephen C., *Pragmatics*, Cambridge University Press, 2008.
- Lyons, John, *Semantics*, Cambridge: Cambridge University Press, 1977.
- Lloshi, Xhevat. *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Shtëpia botuese Albas, Tiranë, 2015.
- Nirvana, Vangjo (Vangjel Koça), “Abeli” dhe “Lyra”: të Etëhem Haxhiademit”, *Tomori*, Tiranë, 1940.
- Plangarica, Tomorr, “Jo vetëm dramaturgu, por edhe poeti (mbi krijimtarinë poetike të Ethem Haxhiademit)”, në *Univers i vlerave të munguara* (ribotim), Sejko, Elbasan, 2002, fq. 100-111.
- Rrokaj, Shezai, *Filozofi e gjuhës. Prej Antikitetit deri në kohën e sotme*, Arbëria, Tiranë, 2010.

Searle, J.R., *Speech Acts: An Essay in the Philosophy of Language*, Cambridge University Press, 1969.

Letërsi e vjelë

Haxhiademi, Etëhem, *Lyra*, Tiranë, Shtypshkronja “Dielli”, 1939.